



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	29.06	3	viti god year
Organ./Niesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHCK	4964/2023		115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.726/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.724/2023 të datës 11.05.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] ankesën me numër A.nr.725/2023 të datës 11.05.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] dhe ankesën me numër A.nr.726/2023 të datës 11.05.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] të bashkuara në ankesën me numër A. 726/2023, kundër organit të punësimit Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 29.06.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.726/2023 e datës 11.05.2023, e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë kompensimin e shpenzimeve të vogla në shumën prej 20% të shpenzimeve ditore për ankueset [redacted] lidhur me periudhën 16 deri 21 prill 2023 (6 ditë).
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunëset Civile [redacted] (me tej ankueset) që të gjitha të punësuarat në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, me datë 11.05.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër refuzimit të kërkesës për

kompensim të shpenzimeve të vogla në shumën 20% të shpenzimeve ditore (mëditje) me pretendimin se Agjencia e Statistikave të Kosovës ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.06/2023 për Kompensimin e Udhëtimeve Zyrtare dhe Shpenzimet e Përfaqësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueseve të Agjencia e Statistikave të Kosovës, ndërsa, kjo e fundit më datë 19.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë si dhe shkresat ndërlidhur më çështjen.

Me Vendimin me numër protokolli 4714 të datës 12.06.2023 të Kryetarit të Këshillit, ankesa me numër A.nr.724/2023, ankesa me numër A.nr.725/2023 dhe ankesa me numër A.nr.726/2022 të datës 11.05.2023, janë bashkuar në ankesën më numër A.726/2023, për shkak së ankesat bazohen në të njëjtën gjendje faktike dhe bazë ligjore.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke u bazuar në nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendim me numër protokolli 4923/2023 të datës 27.06.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës A.nr.726/2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4187/2023 të datës 11.05.2023 e parashtruar nga ankuesja Valdete Navakazi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Letër për ftesë e datës 20.03.2023; Çertifikatën e datës 20.03.2023; Programi për vizitë studimore prej datës 16.04.2023 deri më datën 21.04.2023; Agjendën për punëtori prej datës 17.04.2023 deri më datë 21.04.2023; Kërkesën për udhëtim e datës 12.04.2023; e-mail zyrtar i datës 12.04.2023; Kërkesë për udhëtim zyrtar jashtë vendit e datës 12.04.2023; E-mail zyrtar i datës 04.05.2023; Llogaritja e shumës për akomodim për

Itenerari i udhëtimit nga kompania Big Travell; Udhëtimi i datës 21.04.2023; Përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit i datës 22.05.2023 bashkë me shkresat e lëndës; Ankesa me numër protokolli 4186/2023 e datës 11.05.2023 e parashtruar nga ankuesja

në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; shkresë e datës 18.05.2023-njoftim për mosrespektimin e Rregullores (QRK)Nr.06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzimet e Përfaqësimit nga zyrtarja V.S në Departamentin e Statistikave Sociale-ASK; E-mail zyrtar i datës 10.05.2023; E-mail zyrtar i datës 14.04.2023; E-mail zyrtar i datës 25.05.2023; Akt emërimi me nr.04-052-834 i datës 15.12.2017; Akt emërimi i datës 05.04.2023 me nr.04-052-290; përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë i Statistikave i datës 25.02.2013; Vendim nr.04-052-124 i datës 20.02.2013 me; Ankesa me numër protokolli 4185/2023 të datës 11.05.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 19.05.2023 bashkë me shkresat e lëndës; E-mail zyrtar i datës 10.05.2023; e-mail zyrtar i datës 14.04.2023; Akt emërimi i datës 30.04.2019 me nr.04-052-818; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë i regjistrit civil i datës 13.03.2019, Vendimi numër protokolli 4923/23 të datës 27.06.2023 i Kryetarit të Këshillit, për bashkimin e ankesave, provat shtesë më numër protokolli 271/2023 të datës 27.06.2023 si emaili i datës 29.12.2022 nga A. Kastrati për ankuesen

emaili i datës 11.01.2023 nga ankuesja për A. Kastrati, emaili i datës 09.02.2023 nga ankuesja V. Sefaj për përfaqësuesin e SIDAS, emaili i datës 11.01.2023 nga

ankuesja për A.Kastarati, vërtetime i datës 05.04.2023 për marrëdhënien e punës lëshuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, e-maili i datës 10.05.2023 nga ankuesja për Kryeshefin Ekzekutiv fq. ¼ dhe Vërtetimi me numër protkollli 01-03-344 i datës 06.04.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankueseve *është e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankueset janë të punësuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, rrjedhimisht ankuesja sipas Aktit të Emërimit me numër prorokollli04-052-290 të datës 05.4.2013 ushtron pozitën e punës Zyrtare e Lartë e Statistikave Vitale, ankuesja sipas Aktit të Emërimit me numër protokolle 04-052-834 të datës 15.12.2017 ushtron pozitën e punës Udhëheqëse e Divizionit të Statistikave të Popullsisë, ndërsa, ankuesja sipas Aktit të Emërimit 04-052-818 të datës 30.04.2019 ushtron pozitën e punës Zyrtare e Lartë e Regjistrit të Popullsisë.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton së me kërkesë të Drejtorit të Departamenti të Statistikave Sociale (emaili i datës 29.12.2022 dhe 11.01.2023), Projekti SIDA-së kishte organizuar një vizitë studimore me temën "*Statistikat e Popullsisë së Kosovës*" e mbajtur në Suedi nga data 16.04.2023 deri me datë 21.04.2023, e në të cilën vizitë kanë marrë pjesë ankueset.

Bazuar në sqarimet e SIDA-s të datës 12.04.2023, ky projekti ka mbuluar shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet e akomodimit (fjetjes) dhe shpenzimet e ushqimit, dhe nuk ka paguar ndonjë shpenzim të imtë (cash), kurse me datë 10.05.2023 Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës në shkresën/kërkesën e datës 12.04.2023 të parashtruar nga ankueset për udhëtim zyrtar dhe miratim të kompensimit të shpenzimeve të imta ditore kishte refuzuar kompensimin e këtyre shpenzimeve me mbi shkrimin se: "*Nuk mund të realizohet kërkesa për shkak së sqarimet janë pas realizimit të vizitës studimore, kështu qe mbi këtë bazë edhe Njësia e Financave kishte refuzuar kompensimeve e shpenzimeve të imta ditore.*"

Ankueset pas refuzimit të kërkesës për shpenzime të vogla të përcaktuara në shumën 20% të shpenzimeve ditore, parashtrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin se Agjencia e Statistikave të Kosovës ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.06/2023 për Kompensimin e Udhëtimeve Zyrtare dhe Shpenzimet e Përfaqësimit.

Në funksion të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe në kuptim të vendosjes së drejtë dhe meritore, Kolegji i'u referua Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, përkatësisht nenit 37 ku përcaktohet se: *Zyrtaret/ët publik/e, funksionaret/ët publik/e dhe kategoritë e tjera të të punësuarave/ëve që paguhen nga buxheti i shtetit kanë të drejtë të kompensohen për shpenzimet e kryera për udhëtime dhe për qëndrim zyrtar brenda dhe jashtë vendit. 2. Zyrtaret/ët publik/e, funksionaret/ët publik/e dhe kategoritë e tjera të të punësuarave/ëve që paguhen nga buxheti i shtetit, gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, kanë të drejtë të kompensohen për shpenzimet e kryera për përfaqësim. 3. Kushtet, mënyra, vlera e kompensimit dhe procedura për përfitimin e kompensimit, sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni, miratohen me akt nënligjor të Qeverisë së Kosovës, me propozim të ministrisë përgjegjëse për financa dhe me pëlqim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike. 4. Kushtet, mënyra, vlera e kompensimit dhe procedura për përfitimin e kompensimit, sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni, për nëpunësit në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e*

Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese rregullohen me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të institucioneve.

Po ashtu, Kolegji mori parasysh edhe Rregulloren (QRK) Nr.6/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzimet e Përfaqësimit, ku me nenin 6 janë përcaktuar mënyra e kalkulimit të shpenzime për udhëtim jashtë vendim, përkatësisht me këto dispozita ligjore është paraparë se: *Pagesa e shpenzimeve të udhëtimit zyrtar llogaritet nga dita e nisjes dhe përfundon ditën e kthimit. Dita e nisjes dhe dita e kthimit, pavarësisht kohës së nisjes apo kthimit, llogariten si ditë të udhëtimit zyrtar. 2. Kur shpenzimet janë në ngarkim tërësisht të palës pritëse, të cilët u sigurojnë zyrtarëve shpenzimet e ushqimit dhe fjetjes, pa u paguar asgjë në dorë, atëherë zyrtari përfiton nga buxheti i organizatës buxhetore të tij, shpenzime të vogla të përcaktuara në shumën 20% të shpenzimeve ditore. 3. Kur shpenzimet janë në ngarkim tërësisht të palës pritëse, të cilët u sigurojnë zyrtarëve shpenzimet e ushqimit dhe fjetjes, duke siguruar edhe shpenzimet e vogla, atëherë zyrtari nuk përfiton para të gatshme nga buxheti i organizatës buxhetore. 4. Kur shpenzimet janë në ngarkim pjesërisht të palës pritëse, të cilët u sigurojnë zyrtarëve vetëm shpenzimet e ushqimit apo vetëm shpenzimet e akomodimit, si dhe pa u paguar asgjë në dorë, atëherë zyrtari përfiton nga buxheti i organizatës buxhetore të tij shpenzime të vogla në shumën prej 20% të shpenzimeve ditore, si dhe shpenzimet e tjera të fjetjes apo të ushqimit që nuk paguhen nga pala pritëse. 5. Shuma prej 20% e shpenzimeve të vogla është pjesë e shpenzimeve të ushqimit dhe penzime të vogla dhe aplikohet vetëm kur shpenzimet e udhëtimit zyrtar janë të mbuluara nga pala pritëse/donatori. 6. Pavarësisht rregullimeve të përcaktuara me këtë Rregullore, shpenzimet e udhëtimit zyrtar nuk mbulohen për një periudhë më të gjatë se një (1) muaj. 7. Ministri i ministrisë përkatëse për financa me Vendim miraton tarifat për udhëtime jashtë Vendit.*

Andaj, nisur nga përcaktimi ligjor si me lart, si dhe në mbështetje të provave materiale të çështjes, Kolegji ka konstatuar së Projekti i SIDA-së, lidhur me realizmin e vizitës studimore në Suedi me temën " *Statistikat e Popullsisë së Kosovës, 17-21 prill 2023*", ka kompensuar shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe ushqimit, pa u paguar asgjë në dorë, kështu që mbi bazën e këtyre fakteve rrjedhë së organi i punësimit në këta rast Agjencia e Statistikave të Kosovës ka qenë e detyruar që nga buxheti i saj të bëjë kompensimin e shpenzime të vogla për ankueset, në shumën prej 20% të shpenzimeve ditore për periudhën nga data 16 deri 21 prill 2023 (6 ditë).

Rrjedhimisht, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës me rastin e refuzimit të kërkesës së ankuesve për kompensimin e shpenzimeve të imta mbi bazën se sqarimet janë dhënë me vonesë gjegjësisht pas realizmit të vizitës, janë të pa bazuara, sepse nga shkresat e lëndës rrjedhë së projekti i SIDA-së me datë 12.04.2023 ka ofruar sqarime lidhur me mbulimin e shpenzimet për pjesëmarrje në vizitën studimore në fjalë dhe mbi bazën e këtyre sqarimeve ankueset po më datë 12.04.2023 kishin parashtruar kërkesë të Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës ASK-së për udhëtim zyrtar dhe pagesë të shpenzimeve të imta.

Ndërlidhur me pretendimin e organit të punësimit së ankueset nuk kanë plotësuar dokumentet që kërkohen sipas Rregullores (QRK) Nr. 6/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzimet e Përfaqësimit, Kolegji ka analizuar nenin 5 të kësaj rregulle më të cilin është përcaktuar se: *Kërkesa për udhëtim zyrtar duhet të bëhet së paku pesë (5) ditë para datës së udhëtimit. 2. Përgjithësisht afatit të përcaktuar në paragrafin 1, kërkesa mund të dorëzohet në afat më të shkurtë se pesë (5) ditë në raste të veçanta dhe të jashtëzakonshme. 3. I punësuari që do të realizojë udhëtimin, kërkesën e bën duke ndjekur procedurën si në vijim: 3.1. plotësohet Formulari i kërkesës për udhëtim Zyrtar; 3.2. formulari i kërkesës duhet të miratohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe pas miratimit duhet t'i dërgohet njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore; 3.3. njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore,*

pas verifikimit të të dhënave, kërkesën e dorëzon tek udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit për miratim; 3.4. udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit miraton kërkesën dhe e përcjellë tek njësi për buxhet dhe financa për ekzekutim; 3.5. udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit nëse vlerëson se kërkesa për udhëtim zyrtar nuk është e arsyetuar dhe nuk ka marrë parasysh shpenzimin më racional, mund t'a kthejë kërkesën për plotësim apo ta refuzojë atë me arsyetim. 4. Asnjë udhëtim zyrtar nuk mund të realizohet pa miratim paraprak nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit, andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe mbështetur në provat e lëndës Kolegji ka gjetur së ankueset me datë 12.04.2023 kanë përgatitur formularët e kërkesave dhe të njëjtit formularë janë miratuar nga udhëheqësi i tyre dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore dhe po me datë 12.04.2023 kërkesa për udhëtim zyrtar i është përcjell Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së si Zyrtari më i Lart Administrativ, i cili përkundër faktit që ka qenë në dijeni për vizitën studimore në fjalë dhe kishte nënshkruar dokumentet për pajisje me vizë nga ankueset (vërtetimi i datës 05.04.2023 dhe 06.04.2023 mbi marrëdhënien e punës), i njëjti kishte lënë në heshtje miratimin e kërkesës për udhëtim zyrtar të datës 12.04.2023 dhe po ashtu me asnjë provë nuk vërtetohet fakti së Kryeshefi Ekzekutiv kishte refuzuar miratimin e pjesëmarrjes së ankuesve në vizitë studimore të financuar nga SIDA, përjashtimisht, që më datë 10.05.2023 (pra pas realizimit të vizitës studimore) i njëjti në vet shkresën-kërkesën e datës 12.04.2023 kishte refuzuar kompensimin e shpenzimeve të imta pra jo pjesëmarrjen në vizitë studimore me arsyetim së sqarimet lidhur me këto shpenzime janë dhënë më vonesë, kështu që mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve, Kolegji i Këshillit konstaton së janë tërësisht të bazuara pretendimet ankimore të ankueseve.

Theksuar si më sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.726/2023

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bëhikëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve;
- Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të ASK-së dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

